



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +383-28535725/535727

Prof. Dr. Ali Topalli, kryesues i KD

Nr. 1991 dt. 04.12.2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, duke vendosur mbi propozimin e menaxhmentit, në mbledhjen e mbajtur më 04.12.2020, morri:

VENDIM

1. Të gjithë punonjësit e administratës të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, kompensohen me shumën e njëhershme prej 350 euro.
2. Kompensimi i kësaj shume do të ekzekutohet me pagën e dhjetorit 2020.
3. Kompensimi do të bëhet nga buxheti i planifikuar me PCF paga dhe mëditje i paraparë për kompensimin e shtesës mujore për nëpunësit civil prej 30 euro, sipas vendimit të qeverisë të Republikës së Kosovës.
4. Obligohet zyra për buxhet dhe financa për realizimin e këtij vendimi.

ARSYETIM

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, duke shqyrtuar propozimin e menaxhmentit për kompensimin e punonjësve të administratës ka konstatuar se buxheti për kompensim të kësaj shume është planifikuar dhe paraparë me PCF të buxhetit të UMIB paga dhe mëditje, i paraparë për kompensimin e shtesës mujore për nëpunësit civil prej 30 euro, sipas vendimit të qeverisë të Republikës së Kosovës. Marrë parasysh se kjo pagesë nuk është bërë në baza mujore, Këshilli Drejtues ka vendosur që kjo pagesë të bëhet si pagesë e njëhershme për vitin kalendarik 2020, në lartësi të përgjithshme prej 350,00 euro.

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t’i dërgohet:

- Arkivit të UMIB;
- Zyrës për buxhet dhe financa;
- Zyrës së personelit;
- Zyrës ligjore.

Prof. Dr. Ali Topalli

Kryesues i KD

